



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:029240

Datë: 26.11.2025

Numri i dokumentit: 08118082

KA.nr.697/2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Gent Bekeri, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Matkos Group HC Sharri” ShPK me NUI 810857758 dhe seli në Shtërpce, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Betim Shala me seli në rrugën “Luan Haradinaj”, nr. 88/1, në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ dhe konstatimit të aktit administrativ të miratuar në heshtje, dhe kërkesës për kthimin në gjendje të mëparshme, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 10.11.2025, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e palëve në procedurë, më 26.11.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si i bazuar propozimi i paditësit “Matkos Group HC Sharri” ShPK me NUI 810857758, me të cilën ka kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme të afatit 30 ditë për dorëzimin e padisë lëndore të datës 23.01.2024, ndaj vendimit 21/201/MMPHI i datës 17.11.2023, të paditurit.
- II. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “Matkos Group HC Sharri” ShPK me NUI 810857758 kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe anulohen në tërësi vendimi nr. 21/201/MMPHI i datës 17.11.2023 i të paditurit.
- III. Vërtetohet se paditësi “Matkos Group HC Sharri” ShPK me NUI 810857758 përmes aktit administrativ të miratuar në heshtje për pesë (5) vjet nga data 06.03.2021 e ka lejen mjedisore për hidrocentralin “Sharri” në ngastrën kadastrale 2374-0 në zonën kadastrale të Shtërpcës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes padisë së datës 23.01.2024 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 21/201/MMPHI të datës 17.11.2023 të së Paditurit, vërtetimin se në bazë të heshtjes administrative e ka lejen mjedisore për hidrocentralin “Sharri” në ngastrën kadastrale 2374-0 në zonën kadastrale të Shtërpçës dhe detyrimin e të Paditurit që t’ia njoh atë leje.

Së bashku me padi ka parashtruar edhe propozim për kthimin në gjendje të mëparshme me propozim që padia e ushtruar ndaj vendimit nr. 21/201/MMPHI të datës 17.11.2023 të konsiderohet e afatshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin KA.nr.55/2024 të datës 18.10.2024 ka aprovuar kërkesëpadija e paditësit dhe ka anuluar në tërësi vendimi nr. 21/201/MMPHI i datës 17.11.2023 i të paditurit, gjithashtu ka vërtetuar se paditësi “Matkos Group HC Sharri” ShPK përmes aktit administrativ të miratuar në heshtje për pesë (5) vjet nga data 06.03.2021 e ka lejen mjedisore për hidrocentralin “Sharri” në ngastrën kadastrale 2374-0 në zonën kadastrale të Shtërpçës.

Dhomat e Shkallës së Dytë pranë kësaj Gjykate duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës të paditurit, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.2186/24 të datës 30.09.2025 ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurit dhe ka prishur Aktgjykimin e atakuar, ndërsa lëndën e ka kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Meqenëse çështja e këtij konflikti administrativë është kthyer në rigjykim dhe rivendosje do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, ku është përcaktuar sipas nenit 110 par. 3 *“Për konfliktet, për të cilat është vendosur prishja e vendimit dhe dërgimi i çështjes për rigjykim, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rigjykim do të zbatohen dispozitat e këtij ligji”*.

Gjykata fillimisht e shqyrtoj propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme, ku ndër të tjera propozuesi-paditësi pretendon se e paditura sipas Aktgjykimit të kësaj gjykate KA.nr.112/23 të datës 16.10.2023 ishte e detyruar që në afate prej 30 ditësh të vendos për kërkesën nr prot 201/21 të datës 19.01.2021 nuk e ka njoftuar dhe në as një mënyrë nuk i ka dorëzuar paditësit vendimin nr. Prot 21/201/MMPHI të datës 17.11.2023, prandaj paditësi bazuar në nenin 68 të Ligjit për konflikte Administrative, të paditurës i është drejtuar me parashtrësë të veçantë me kërkesë që e

njëjta si organ kompetent në zbatim të obligimit sipas Aktgjykimit 112/23 të nxjerrë aktin administrativë – Lejen Mjedisore sipas kërkesës nr prot 4511/18 të datës 07.08.20218, kërkesën nr. Prot 3917/20 të datës 21.08.2020 kërkesën nr prot 201/21 të datës 19.01.2021 dhe kërkesën nr. Prot 369/21 të datës 28.01.2021. pas kalimit të afatit të përcaktuar për vendosje sipas parashtrësave, pranë kësaj Gjykate paditësi ka paraqitur parashtrësë për vendosjen e çështjes sipas nenit 68 të LKA-së, për nxjerrjen e vendimit i cili e zëvendëson aktin administrativ me datë 08.12.2023. Më tej ka theksuar se bazuar në faktin se e paditura nuk kishte respektuar afatin e përcaktuar sipas Aktgjykimit nr. 112/23 të datës 16.10.2023, si dhe propozuesi me datën 01.12.2023 kishte ushtruar parashtrësë për nxjerrjen e aktit administrativë, nuk ka ushtruar padi për fillimin e konfliktit administrativë ndaj vendimit të atakuar duke konsideruar që gjykata do të vepron sipas kërkesës për zëvendësimin e aktit administrativ. Në fund ka theksuar se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë me Aktvendimin KA.nr.112/23 të datës 11.01.2024 ka hedhur poshtë kërkesë padinë e paditësit për nxjerrjen e vendimit i cili e zëvendëson aktin administrativ lidhur me kërkesën e datës 19.01.2021 dhe kërkesën e datës 28.01.2021, vendimin e gjykatës si dhe vendimet e të paditurës i dërgon të autorizuarit të paditësit më datën 17.01.2024, andaj rrjedhë se propozimi për kthim në gjendje të mëparshme është i afatshëm dhe se bashku me këtë propozim është dorëzuar edhe padia për fillimin e konfliktit administrativë ndaj vendimit të atakuar, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar dhe të lejojë kthimin në gjendje të mëparshme.

Lidhur me pretendimit e paditësit për rivendosje në afate, e paditura në as një formë qoftë përmes përgjigjes në padi, e as gjatë deklarimit të mëhershëm dhe as gjatë deklarimit në rigjykim, nuk e ka kundërshtuar këtë propozim, e as nuk ka paraqitur argumente me të cilat do ti zhvlerësonte pretendimet e paditësit ose vetë propozimit për rivendosje në afate.

Gjykata fillimisht vlerësoj afatshmërin e paraqitjes së propozimit për rivendosjen e afatit konformë nenit 39 par.2 të LKA-së ku përcaktohet se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda shtatë (7) ditëve, duke filluar nga dita kur ka pushuar shkaku për të cilin pala ka humbur afatin.”*

Meqenëse paditësi me datën 17.01.2024, ka pranuar Aktvendimin KA.nr.112/23 të datës 11.01.2024 si dhe vendimin e atakuar nr. Prot 21/201/MMPHI të datës 17.11.2023, ndërsa parashtrësën për rivendosje të afatit së bashku me padi e ka paraqitur 23.01.2024 përmes postës, fakte i cili vërtetohet në shkresat e lëndës, rrjedhë se propozimi është paraqitur brenda afatit 7 ditor të përcaktuar në dispozitën e sipër cekur.

Gjykata e aprovoj si të bazuar propozimin për rivendosje të afatit konform nenit 39 të LKA-së në të cilën përcaktohet se. “1. Nëse, për shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashihen e as të evitohen, pala humbë afatin për paraqitjen e padisë apo humb një afat tjetër për kryerjen e një veprimi procedural dhe për pasojë nuk mund të paraqet padinë apo të kryejë veprimin procedural, ajo mund të propozojë rivendosjen e afatit. 2. “Propozimi duhet të paraqitet brenda shtatë (7) ditëve, duke filluar nga dita kur ka pushuar shkaku për të cilin pala ka humbur afatin.” 3. “Propozimi për rivendosjen e afatit nuk mund të paraqitet pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e skadimit të afatit të humbur.” 4. “Shkaqet për arsyeshmërinë e propozimit duhet të paraqiten në kohën e parashtrimit të propozimit. Veprimi procedural gjithashtu duhet të paraqitet bashkë apo sidoqoftë brenda afatit në të cilin është e mundur të paraqitet propozimi për rivendosjen e afatit.” 5. “Nuk lejohet rivendosja e afatit nëse është humbur afati për paraqitjen e propozimit për rivendosjen e afatit apo nëse pala nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për rivendosjen e afatit.” 6. “Propozimi për rivendosjen e afatit i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.” 7. “Kundër aktvendimit për rivendosjen e afatit nuk mund të paraqitet ankesë e veçantë, përveç kur rivendosja e afatit është miratuar në kundërshtim me paragrafin 5 të këtij neni.” Pasi që ekziston arsyetimi për lëshimin e afatit për mos paraqitje të padisë ndaj vendimi të kontestuar nga fakti se paditësi ishte në pritje të vendosjes nga gjykata lidhur me parashtrësë për vendosje konformë nenit 68 të ish LKA-së, gjykata vlerësoj se ekzistojnë kushtet ligjore të përcaktuara me nenin e cituar më lartë, që arsyetojnë në plotësisht rivendosja në afate për paraqitjen e padisë, prandaj të njëjtën e aprovoj dhe e trajtojë padinë si të afatshme.

Pretendimet e paditësit

Paditësi në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor njashtu edhe në rigjykim, ka pretenduar se, e Paditura pas sjelljes së aktgjykimit të kësaj gjykate KA.nr.112/23 të datës 16.10.2023 është obliguar që të sjell vendim për shkak të heshtjes administrative dhe e paditura me datën 17.11.2023 e sjell këtë vendim me të cilin e refuzon kërkesën e paditësit. Paditësi konsideron se e paditura nuk ka pas autoritet përkatësisht autorizim që të refuzoj këtë kërkesë për shkak se në bazë të nenit 98, 100 dhe 46 të Ligjit nr. 05/L-031 paditësit sipas fuqisë ligjore i është njohtë leja mjedisore përkatësisht sipas fuqisë ligjore atij i është aprovuar kërkesa. Prandaj e paditura ishte e obliguar që konform dispozitave të cekura që lëshoj vërtetimin mbi miratimin në heshtje apo vendimin me të cilën aprovohet kërkesa për leje mjedisore. Më tej ka shtuar se, përkundër këtij

fakti dhe po që se supozohet se dispozitat e cekura ligjore nuk mund të aplikohen në çështjen konkrete edhe vet vendimi është vendimi i kundërshtuar, është sjellë në mënyrë të kundërligjshme pa i vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha faktet në të cilin do të vërtetohej se paditësi i ka plotësuar të gjitha kushtet për lëshimin e lejes mjedisore.

Pos tjerash ka pretenduar se e Paditura në vendimin e kontestuar ka konstatuar se paditësi në ngastrën kadastrale numër 2374/0 ZK Shtërpcë nuk i plotëson kriteret e parapara me UA nr. 04/2022 për leje mjedisore, pasi mungojnë kushtet si në vijim: 1. Ndërrimi (devijimi) i trasesë nga koordinatat e shënuara në raportin VNM; 2. Nuk ka pëlqim mjedisor për ndërrim apo devijim të trasesë; 3. Traseja kalon nëpër zonën 2 të mbrojturat të Parkut kombëtar Sharri me gjatësi 1056 metra. Këto konstatime të paditurës nuk janë konstatime të cilat do të ndikojnë në refuzimin e kërkesës për shkak të faktit se me pëlqimin mjedisor i jepet leja për hapësirën në tërësinë e saj ku do të realizohet projekti e jo vetëm për koordinatat ku do të kalon projekti dhe me qëllim të dëshmimit se me realizimin e këtij projekti nuk është dëmtuar natyra dhe se nuk ka ndikim të dëmshëm në mjedis paditësi ka angazhuar ekspert profesional të cilët kanë hartuar studim në lidhje me këtë situatë e në të cilin i janë dhënë shpjegimet administrativo – teknike e mjedisore të segmenteve të trasesë së HC Sharri dhe në bazë të këtyre studimeve rezulton se devijimi i segmenteve të caktuara të trasesë fillestare / ideore sipas VNM nuk nënkupton edhe ndryshimin e korridorit të trasesë të tubave të HC Sharri në aspektin tekniko – mjedisor, për faktin se dimensionet ekzistuese të trasesë përcaktohen sipas legjislacionit të ndërtimit përkatësisht me nenin 7 të UA për ndërtim. Më tutje integrimi i tubave nëntokësor të HC Sharri në trupin e rrugës rajonale përveç zgjidhjes teknike – mjedisore që është shumë më i favorshëm në raport me planin ideor në aspektin ligjor ka përfshirje formale edhe nga 3 dokumente administrative pëlqimin e Komunës së Shtërpcës, pëlqimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore. Më tej e paditura me konstatimet në vendimin e kundërshtuar ia ka mohuar edhe të drejtën paditësit për ndryshim të trasesë e drejtë e cila i takon sipas Ligjit të Ndërtimit dhe në harmoni me listën e projekteve të shtojcës 1 dhe 2 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kapitujt për infrastrukturës për tubat të ujit me të cilat nuk kërkohet VNM, përderisa kapitulli i shfrytëzimit të ujërave dhe energjetikës për HC Sharri – objektin e hidrocentralit është kryer me raportin e VNM-së dhe pëlqimin mjedisor, për vërtetimin e fakteve të cekura janë dorëzuar prova materiale dhe atë raportin mjedisor të përpiluar nga ing dpl. Brisilda Gjana si dhe shpjegimin administrativo teknik i segmenteve të trasesë HC Sharri në të cilat më detajisht pasqyrohen pretendimet e paditësit për të drejtën e tij për realizimin e projektit me të cilën nuk cenohet mjedisi e me qëllim të marrjes të lejes mjedisore. Pos tjerash,

ka deklaruar se ai me rastin e dorëzimit të dokumentacionit për marrjen e lejes mjedisore ka dorëzuar edhe raportin mjedisor për instalimin nëntokësor të gypave për veprën hidrikë HC Sharri me të cilën dëshmohet se traseja e përdorur për shtrirjen e gypave në nëntokë në thellësi prej 50 cm dhe i mbuluar nuk paraqet dëm mjedisor pasi që me këtë nuk është tjetërsuar asnjë tokë, habitat apo zonë e cila ndikon ose ka ndikime negative në zonën e mbrojtur. Me këtë veprim të paditësit është bërë edhe mirëmbajtja infrastrukturore pasi që paditësi ka rehabilituar të gjithë segmentin rrugor pas shtrimit të tubacioneve në anën e rrugës duke shkaktuar sa më pak ndërhyrje në të.

Lidhur me afatshmërin e padisë ka deklaruar: se së bashku me padi ka ushtruar edhe propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme, në të cilën janë paraqitur të gjitha arsyet dhe faktet duke pretenduar se duhet të lejohet kthimi dhe se padia të konsiderohet e afatshme, në realitet paditësi pas kalimit të afatit 30 ditor për sjelljen e vendimit sipas aktgjykimit të kësaj gjykate, e njëjta nuk ka sjell vendimin dhe paditësi së pari i drejtohet të paditurës me parashtresë për të vepruar konform aktgjykimit të kësaj gjykate, dhe atë bazuar në nenin 68 të LKA-së dhe këtë parashtresë të veçantë të paditurës ia dorëzon me datë 01.12.2023, dhe pas kalimit të afatit të parapare ligjor prej 7 ditësh, paditësi në këtë gjykatë ushtron kërkesën për nxjerrjen e vendimit, i cili zëvendëson aktin administrativë, këto veprime të paditësit janë ndërmarr pasi që deri në ditën e parashtimit në gjykatë, nuk ka qene i njoftuar për sjellje të vendimit nga ana e të paditurës. Më tej ka theksuar se e paditura me sjelljen e vendimit të kontestuar Nr.201-2/211, datës 17.11.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 10 të UA numer 07/2017, për lejen mjedisore, pasi që e paditura nga dita e pranimit të kërkesës për lëshimin e lejes mjedisore ka tejkaluar afatin ligjor të përcaktuar me këtë dispozitë, që e njëjta ta shqyrton kërkesën dhe të pergatit propozim-vendimin, po ashtu pas kalimit të këtij afati paraprakisht nuk i është drejtuar paditësit që eventualisht në qoftese e paditura paraprakisht ka konstatuar se aplikacioni dhe dokumentacioni nuk është i kompetuar, ashtu që bazuar në këtë afat të përcaktuar në kete dispozite ligjore konform nenit 98, par.1 të LPPA-së përcaktihet se proceduar administrative e nisur sipas kërkeses do të përfundoj sa më shpejt që eshte e mundur por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj të veqante për atë lloj të procedurës. Me dispozitën e nenit 31, par.3 të Ligjit nr. 03/L-025, Për mbrojtjen e mjedisit, përcaktohet se Ministria, me akte nenligjore përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, kështu që bazuar në këtë dispozitë, me anë të UA 07/2017 është përcaktuar afati ligjor sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, ashtu që në këtë çështje administrative në bazë të nenit 100 të LPPA-së, paditësi sipas fuqisë ligjore fiton përkatesisht i njihet e drejta në leje mjedisore, pasi që me mos veprim të paditurës, e konform nenit 100 lidhur

me nenin 46, par.3 të Ligjit 05-L-031, kërkesa e paditësit është miratuar në heshtje, e mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazën e faktit se që nga dita e ushtrimit të kërkesës për paisje me leje mjedisore dhe të kalimit të afatit më shumë se 180 ditë nga dita e ushtrimit të padisë, paditësi sipas fushës ligjore posedon leje mjedisore. Paditësi konsideron se akti administrativ i kundërshtuar me këtë padi është i kundërligjshëm nga vetë fakti se me kërkesën e datës 20.08.2021, nga e paditura është kërkuar lëshimi i vërtetimit mbi miratim në heshtje të kërkesë mbi dhënien e lejes mjedisore për hidrocentralin Sharri me kapacitet mbi 6.45 megvat. Nga vetë përmbajtja e aktit administrativ të kundërshtuar vërtetohet se e paditura nuk ka vendosur në bazë të kësaj kërkesë, por faktikisht ka vendosur për kërkesën bazë, për lëshimin e lejes mjedisore, dhe si e tillë është e kundërligjshme. Konsideroj se kërkespadija është e bazuar, pasi që me aktin administrativ të kundërshtuar nuk është vendosur për kërkesën e datës 20.08.2021, dhe e paditura nuk ka pasur më asnjë autorizim ligjor që të vendos për kërkesën e datës 19.01.2021, për lëshimin e lejes mjedisore.

Për fund ka deklaruar se duhet të ekzistoj siguria juridike për secilin qytetar të Republikës së Kosovës dhe se dispozitatat ligjore duhet të aplikohen në mënyrë të njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë dhe organet administrative sipas fuqisë ligjore, pjesëmarrësit në procedurë administrative duhet të njihet e drejtën e cila është fituar sipas fuqisë ligjore, ndaj i ka propozuar gjykatës që fillimisht të vendos lidhur me kërkesën për kshimin në gjendjen e mëparshme për dhënien për paraqitjen e padisë, ndërsa padinë dhe kërkespadinë ta aprovojë si të bazuar.

I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai në përgjigje në padi ka deklaruar se me vendimin e goditur është konsultuar se Paditësi nuk i plotëson kushtet e parapara me UA MMPH nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, pas atij i mungon plotësimi i disa kushteve. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ende konsideron se padia e paditësit është jashtë afatit ligjor, pasi vendimi nga ana e paditësit është pranuar me datën 11.12.2023, ndërsa padia e paditësit është paraqitur në gjykatë me datën 25.01.2024. Po ashtu pas pranimit të aktgjykimi KA.nr.112/23, datën 18.10.2023 brenda afatit ligjor, datë 17.11.2023 e paditura sipas vërejtjeve të gjykatës ka nxjerr aktvendimin me nr.prot.21/201/MMPHI. E paditura pas shqyrtimit të kërkesës për leje mjedisore për padisin për hidrocentralin Sharr për ngastrën kadastrale Shtërpçë 2374-0 ZK Shtërpçë ka konstatuar se nuk i plotëson kriteret e

parapara me UD 04/2022, për leje mjedisore, pasi që i mungojnë plotësimi i disa kushteve, e të cilat janë të cekuar në vendimin e kontestuar e që në bazë të këtyre të gjeturave dhe bazuar në nenin 12, par. 3 të UA të lartë cekuar ka marr vendim për refuzimin e lejes mjedisore, andaj bazuar në të lartcekura se nuk kemi miratim të aktit administrativ në heshtje siç pretendon paditësi.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në rigjykim, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: vendimi nr. 21/201/MMPHI i datës 17.11.2023 i të paditurit; aktvendimi KA.nr. 112/23 i datës 11.01.2024 i Gjykatës Komerciale; aktgjykimi KA.nr.112/23 i datës 16.10.2023 i Gjykatës Komerciale; parashtrësja dorëzuar Gjykatës Komerciale më 08.12.2023 me numër KA.nr. 112/23 me kërkesë sipas nenit 68 par. 2 i LKA-së; parashtrësja e veçantë e dorëzuar nga Matkos Group ShPK për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër të protokollit 7063/23 të datës 01.12.2023; kërkesa për lëshimin e vërtetimit mbi miratimin në heshtje mbi dhënien e lejes mjedisore për hidrocentralin Sharr me kapacitet 6.45MW e protokolluar të i padituri me numër 201-2/2021 më 20.08.2021; formulari i kërkesës për leje mjedisore dorëzuar nga paditësi për të paditurin me nr. prot. 201/21 më 19.01.2021; komunikimi me e-mail i datës 06.09.2019 ndërmjet Bajram Kafexholli dhe Fadil Gashi, Bedri Halimi, Ilir Morina; pëlqimi me numër 06-350/02-13142/19 i datës 12.09.2019 lëshuar nga komuna e Shtërpçës; vendimi me numër të protokollit 1792 i datës 10.02.2020 lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit; kontrata për shfrytëzimin e brezit rrugor me numër të protokollit 1800 të datës 10.02.2020 lidhur ndërmjet paditësit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; fletë pagesa me numër 004878 e datës 10.02.2020; përgjigjja me nr. prot. 2195-2/20 e datës 14.04.2020 lëshuar nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit; vendimi nr. LU.11 i datës 09.02.2021 i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit; shpjegimi administrativo-teknik e mjedisor i segmenteve të trasesë së HC-Sharri i vitit 2024 pa datë konkrete; raporti mjedisor – instalimi nëntokësor i gypave për veprën hidrike HC Sharri e muajit maj 2024 hartuar nga Ing. Dpl. Brisilda Gjana; kronologjia e shqyrtimit të lëndës dorëzuar nga e paditura; lista e distribuimit me numër të referencës 21/201/24/MMPHI-DMMU i datës 17.11.2023; procesverbali i takimit të datës 15.11.2023 dhe vazhdimi i takimit më 17.11.2023 i komisionit për leje mjedisore, së bashku me komunikimin me email dhe hartat e bashkangjitura; njoftimi për vendimin për leje mjedisore me numër të protokollit 201-2 i datës 17.11.2023 mbi të cilët

gjendet data e pranimi të këtij vendimi nga i padituri, dhe certifikata e përdorimit nr. 63-351/02-11207/20 i datës 27.10.2020 lëshuar nga komuna e Shtërpçës; Aktgjykimi KA.nr.1256/22, datës 20.02.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës; Aktgjykimi K.DH.SH.II.nr.1195/24, datës 21.07.2025.

Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 2 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike si në vijim.

Paditësi më 19.01.2021 kishte paraqitur te i Padituri kërkesën për leje mjedisore lidhur me hidrocentralin në Sharrë të Shtërpçës, të protokolluar me numrin 201/21 te i Padituri. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes formularit të kërkesë për leje mjedisore 201/21 të datës 19.01.2021.

I Padituri brenda afatit të përgjithshëm prej 45 ditëve nuk kishte kërkuar nga Paditësi dorëzimin e ndonjë dokumenti tjetër ose ndonjë sqarim, si dhe nuk kishte marrë vendim për zgjatjen e afatit, e as nuk kishte vendosur për kërkesën e Paditësit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes aktgjykimit KA.nr.112/23 i datës 16.10.2023 i kësaj gjykate.

Paditësi pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi, në bazë të cilës kjo gjykatë përmes Aktgjykimit KA.nr.112/23 të datës 16.10.2023 duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e Paditësit, e kishte detyruar të Paditurin që brenda 30 ditëve të vendosë mes tjerash për kërkesën për pajisje me leje mjedisore të Paditësit me numër të protokollit 201/21 të datës 19.01.2021 dhe vendimin t'ia dërgoi Paditësit. Këtë aktgjykim i Padituri e ka pranuar më 18.10.2023. Edhe këto fakte gjykata i vërtetoi nga aktgjykimi KA.nr.112/23 i datës 16.10.2023 i kësaj gjykate, mbi të cilin shihet edhe vula e pranimi të paditurit.

Paditësi me datë 01.12.2023 kishte paraqitur kërkesë te i Padituri që ta zbatohet aktgjykimi KA.nr.112/23 i datës 16.10.2023 i kësaj gjykate, përkatësisht të nxjerrë aktin administrativ sipas kërkesë 201/21 të datës 19.01.2021. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes parashtresës së veçantë të protokolluar te i Padituri më 01.12.2023 me numër 7063/23.

Paditësi më 08.12.2023 i ishte drejtuar kësaj gjykate me parashtresë, me të cilën ka kërkuar nga kjo gjykatë që në bazë të nenit 68 para. 2 të LKA-së të nxjerr vendim që e zëvendëson aktin administrativ. Fakt i cili u vërtetua nga parashtresa e cekur.

I Padituri më 11.12.2023 ia kishte dorëzuar Paditësi vendimin e goditur nr. 21/201/MMPHI të datës 17.11.2023, me të cilin e kishte refuzuar kërkesën e Paditësit për leje mjedisore, me arsyetimin se pas shqyrtimit të kërkesë për leje mjedisore ka konstatuar se Paditësi nuk i plotëson kushtet. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes njoftimit për leje mjedisore me numër të protokollit 201-2/21 të datës 17.11.2023 mbi të cilin është vendosur emri i përfaqësuesit të Paditësit dhe data e pranimit të tij, si dhe vendimit të goditur.

Gjatë zhvillimit të procedurës sipas lëndës KA.nr.112/2023, Gjykata në bazë të kërkesës së saj ishte njoftuar nga i Padituri se ky i fundi e ka nxjerrë vendimin sipas aktgjykimit KA.nr.112/23 të datës 16.10.2023 të kësaj gjykate, rrjedhimisht kjo gjykatë kishte vendosur që ta hedh poshtë kërkesë e Paditësit për vendosje sipas nenit 68 para. 2 të LKA-së, pasi ndaj vendimit të nxjerrë nga i Padituri mund të iniciohet konflikti administrativ. Këtë vendimin Paditësi e ka pranuar më 17.01.2024. Këto fakt gjykata i vërtetoi përmes aktvendimit KA.nr.112/23 të datës 11.01.2024 të kësaj gjykate.

Përveç kësaj, gjykata gjithashtu konstaton se Paditësi posedon pëlqim nga komuna e Shtërpçës lidhur me vendosjen e gypave në koordinatat e caktuar, pëlqim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për shtrirjen e gypit në trasenë e rrugës rajonal R210 në drejtimin Brezovicë-Sharr si dhe kontratë për shfrytëzimin e brezit të kësaj rruge për t'i mundësuar ndërtimin (vendosjen) e gypit metalik, leje ujore për hidrocentralin Sharri nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pëlqim mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndërtimin e hidrocentraleve gjeneruese me pajime përcjellëse H1 Sharri, pëlqim uxor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me ndërtimin e hidrocentralit HEC-Sharri, leje ndërtimore nga komuna e Shtërpçës për ndërtimin e hidrocentralit Sharri, certifikatë të përdorimit nga komuna e Shtërpçës lidhur me përdorimin e hidrocentralit Sharri. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes vendimeve, leje dhe pëlqimeve përkatëse të lëshuara nga ministritë, respektivisht, Komunat përkatëse, cilat janë cekur në arsyetim.

Gjykata vlerësoi edhe provat tjera të administruara në këtë çështje por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse dhe as me ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë çështje, andaj të njëjtat nuk i shqyrtoi secilën veç e veç.

Vlerësimi meritor i rastit

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave ligjore të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia

e Paditësit është e bazuar në ligj, rrjedhimisht akti administrativ i goditur duhet të anulohet dhe është konstatuar se Paditësi tani më e ka të miratuar në heshtje kërkesë për leje mjedisore.

Gjykata rikujton se Paditësi më 19.01.2021 kishte paraqitur kërkesë për tu pajisur me leje mjedisore për përdorimin e hidrocentralit Sharri në ngastrën kadastrale 2374-0 në zonën kadastrale të Shtërpcës, ndërsa i Padituri brenda afatit të përgjithshëm ligjore prej 45 ditëve nuk e kishte vendosur me akt administrativ lidhur me atë kërkesë, nuk e kishte shtyrë afatin për vendosje sipas asaj kërkesë, e as nuk kishte kërkuar dokumente shtesë ose sqarime shtesë nga Paditësi. Kjo situatë është e rregulluar me dispozitat e LPPA-së ku është përcaktuar në nenin *Neni 98 Afati për përfundimin e procedurës administrative 1. “Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure”. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. 3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës. Ndërsa me nenin 99 të po të njëjtit ligje është përcaktuar Shtyrja e afatit të procedurës administrative 1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar. 3. Vendimi procedural i shtyrjes të afatit fillestar dhe data e re e mbarimit të tij, i njoftohet palës, brenda afatit fillestar dhe duhet të jetë e arsyetuar.*

Lidhur me miratimin në heshtje të aktit administrativë përcaktohet në *Neni 100 të LPPA-së, “Akti administrativ i miratuar në heshtje 1. Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar (në vijim: ”akti administrativ*

i miratuar në heshtje”).2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet kur parashihet ndryshe me ligj. 3. Në rast të një akti administrativ të miratuar në heshtje, pala ka të drejtë të marrë nga organi kompetent një vërtetim me shkrim për përmbajtjen e tij, siç është paraparë në paragrafin 3 të nenit 46 të këtij Ligji. 4. Dispozitat e këtij Ligji për pasojat juridike, ligjshmërinë, shfuqizimin dhe anulimin e akteve administrative, si dhe për mjetet juridike, zbatohen gjithashtu, përshtatshëmrisht edhe për aktin administrativ të miratuar në heshtje”.

Pas vlerësimit të dispozitave të sipër cekura, organi administrativ e ka për obligim që lidhur me një kërkesë të palës të vendosë brenda afatit ligjor me akt administrativ përfundimtar, por jo më vonë se afati i veçantë i paraparë me ligjin përkatës ose jo më vonë se afati i përgjithshëm prej 45 ditëve, afate ligjor i përcaktuar sipas dispozitave të LPPA-së, përjashtimisht kur pala pas parashtrimit të kërkesës duhet të dorëzoj ndonjë dokument ose të kryej ndonjë veprim procedural për të cilin është i detyruar me ligj.

Në vazhdim nga dispozitat e cituara më lart, kuptohet se organi administrativ mundet vetëm njëherë ta shtyjë afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, duke e njoftuar palën brenda afatit fillestar me vendimin e arsyetuar për shtyrjen e afatit fillestar, në të cilin ceket data e re e mbarimit të procedurës.

Po ashtu, nga dispozitat e cituara më lartë kuptohet se kur organi administrativ dështon që të vendosë brenda afatit fillestar ose të shtyrë në mënyrë të rregullt nxjerrjen e vendimit të shkruar sipas kërkesë së palës, atëherë kërkesa e palës juridikisht në bazë të ligjit konsiderohet e aprovuar në tërësi.

Akti i tillë, pra akti administrativ për miratimin në heshtje të kërkesës, është i juridikisht i vlefshëm dhe i barabartë me një akt administrativ të shkruar për miratimin e kërkesë, meqenëse për pasojat juridike, ligjshmërinë, shfuqizimin dhe anulimin e akteve administrative, si dhe për mjetet juridike ndaj aktit administrativ të miratuar në heshtje zbatohet po të njëjta dispozita juridike. Pra, pasoja juridike e aktit të miratuar në heshtje është “prodhimi” *ex lege* i një akti administrativ në formën e “aktit administrativ fiktiv” që përmbush plotësisht kërkesën e palës, gjegjësisht akti administrativ i miratuar në heshtje prodhon të njëjtën pasojë juridike si një akt administrativ i formës së plotë: i jep të drejtën palës kërkuese të kryejë veprimtarinë ose të kryejë veprimin, autorizimi i të cilit kërkohej nëpërmjet paraqitjes së kërkesës.

Akti administrativ i miratuar në heshtje krijon një realitet të ri ligjor ndaj palëve të tjera të interesuara me interesa të kundërta. Të cilëve i mundësohet të kundërshtojnë aktin administrativ të miratuar në heshtje me ankesë administrative njësoj si çdo akt tjetër administrativ sipas nenit 125 të LPPA-së. Për më tepër, akti administrativ i miratuar në heshtje, si dhe çdo akt tjetër akti administrativ dobiprurës mund të anulohet ose shfuqizohet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara nga LPPA-ja. Për më tej, në bazë të kësaj dispozite, heshtja e administratës ndaj skadimit të afatit bëhet e barasvlershme me një akt administrativ të qartë pozitiv dhe dobiprurës.

Në këto raste, organi administrativ e ka obligim ligjor që të lëshoj një vërtetim për përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje, jo vetëm për palën, kërkesa e të cilit është miratuar në heshtje, por edhe për palët tjera të cilat mund të kenë interesa të kundërta me parashtruesin, kërkesa e të cilit është miratuar në heshtje, ose vet ndonjë autoritet publik tjetër me qëllim të vërtetimit të përmbajtjes së aktit administrativ të vërtetuar në heshtje.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 100 të LPPA-së për aktin administrativ të miratuar në heshtje, meqenëse i Padituri nuk e ka nxjerr vendimin për leje mjedisore brenda afatit fillestar (negativ ose pozitiv për kërkuesin) e as nuk e ka shtyrë afatin fillestar, ndërsa në anën tjetër nga shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh se Paditësi si parashtrues i kërkesës në procedurën administrative së bashku me kërkesën e tij nuk e ka dorëzuar ndonjë dokument për të cilin ligjërisht ka qenë i obliguar e as nuk ka pasur kërkesë brenda afatit fillestar nga i Padituri që Paditësi ta plotësoj kërkesën e tij për leje mjedisore me ndonjë dokument shtesë. Gjatë vlerësimit, gjykata gjen se në rastin konkret nuk zbatohet pengesa ligjore nga neni 100 para. 2 i LPPA-së, pasi në Ligjin për 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (këtu e tutje LMM), në bazë të cilit lëshohet leja mjedisore, nuk ka asnjë dispozitë që shprehimisht e ndalon aktin e miratuar në heshtje. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk vlen pengesa ligjore nga neni 135 para. 3 i LPPA-së, meqenëse procedura administrative nuk ishte zhvilluar në shkallën e dytë. Gjithashtu, gjykata gjen se në rastin konkret nuk zbatohet as pengesa ligjore nga neni 160 i LPPA-së, meqenëse procedura administrative konkrete ka filluar pas më shumë se dy viteve nga hyrja në fuqi e LPPA-së.

Prandaj nën këto rrethana, nga fuqia e ligjit kërkesa e Paditësi për leje mjedisore është miratuar përmes heshtjes së të Paditurit, kurse në rastet të këtilla i Padituri si organ administrativ juridikisht e ka pasur vetëm një autorizim, që në të njëjtën kohë për atë paraqet obligim ligjor, që ta lëshoj vërtetimin lidhur me përmbajtjen aktit administrativ të miratuar në heshtje.

Për më tej, në rastet kur kemi akt administrativ të miratuar në heshtje, organi administrativ nuk ka asnjë tagër ligjor që të shtyjë ndonjë afat, të kërkoj dokumente shtesë ose kryerjen e ndonjë veprimi procedural nga pala, të kryej vet ndonjë veprim procedural, të shqyrtoj bazueshmërinë e kërkesës së palës, të refuzoj kërkesën e palës e madje as të “aprovoj” kërkesën e palës, meqenëse atë veç e ka miratuar ligji, por organi administrativ vetëm mundet dhe duhet në bazë të kërkesës së palës ose ndonjë pale tjetër të interesuar të lëshoj një vërtetim lidhur me përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje. Pra, pasiviteti ose heshtja administrative bëhet ekuivalente me një vendim pozitiv të shprehur dobiprurës për palën kërkuuese, e cila mund të fillojë veprimtarinë për të cilën është kërkuar autorizimi.

Duke qenë se me LMM nuk është caktuar asnjë afat për të vendosur sipas kërkesës për leje mjedisore, atëherë në këto raste vlen afati i përgjithshëm prej 45 ditëve, i paraparë me nenin 98 para. 2 të LPPA-së. Meqenëse Paditësi si palë në procedurën administrative kërkesën për leje mjedisore e ka paraqitur më 19.01.2021 (ditë e martë) drejtpërdrejtë në zyrat e të Paditurit, atëherë afati i përgjithshëm për të vendosur sipas kërkesës në bazë të nenit 81 para. 2 të LPPA-së ka filluar të rrjedhë nga data 20.01.2021 dhe ka përfunduar me kalimin e ditës së datës 05.03.2021 (ditë e premte). Me kalimin e ditës së fundit të afatit prej 45 ditë pa e dhënë aktin administrativ për vendosjen sipas kërkesës për leje mjedisore, në ditën pasuese, pra më 06.03.2021, në bazë të ligjit kërkesa e Paditësit për leje mjedisore ishte aprovuar në heshtje, rrjedhimisht Paditësi që nga data 06.03.2021 ligjërisht ishte i pajisur me leje mjedisore dhe në bazë të aktit administrativ të miratuar në heshtje i ka pasur të gjitha autorizimet sikur të kishte pas aktin administrativ të shkruar për dhënien e lejes mjedisore.

Për këtë arsye gjykata si datë të lejes mjedisore e caktoi datën 06.03.2021. Gjithashtu, meqenëse sipas nenit 33 para. 2 të LMM-së vlerëfshëria kohore e lejes mjedisore është e kufizuar në pesë (5) vite, atëherë gjykata erdhi në përfundim se leja mjedisore e aprovuar në heshtje ka fuqi juridike për pesë vite nga dita e miratimit në heshtje.

Lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata sqaron se dispozitat e LKA-së dhe LPPA-së nuk kanë paraparë asnjë zgjidhje juridike për situatën kur akti administrativ *ex lege* miratohet në heshtje, por autoriteti publik (i) heshtë edhe ndaj kërkesë së palës që të lëshoj një vërtetim për përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje, (ii) me akt administrativ e refuzon kërkesën e palës për lëshimin e vërtetimit të përmbajtjes së aktit administrativ të miratuar në heshtje ose (iii) lëshon akt administrativ, me të cilin e refuzon kërkesën fillestare të palës për dhënien e aktit administrativ, siç ka ndodhur në rastin konkret. Megjithatë, kjo gjykatë vlerëson se qëllimi i

fiksionit juridik pozitiv për heshtjen e organeve administrative është të shmangë pasojat e mungesës së efikasitetit të administratës, që synon nxitjen e performancës së administratës nëpërmjet faktorit pengues ndaj mosveprimit, dhe, në të njëjtën kohë, garanton realizimin e të drejtave të palës si mjet i fundit.

Duke e marrë parasysh këtë qëllim ligjor dhe pasojat juridike të sqaruar më lartë lidhur me aktin administrativ të miratuar në heshtje, atëherë gjykata vlerëson se mundet me vendim ta konstatoj ekzistimin e aktit administrativ të miratuar në heshtje, si rrugë të vetme juridike të palës, dhe nuk është e nevojshme që pala të kërkoj nga gjykata së që pari ta detyroj autoritetin publik të nxjerrë akt administrativ për të cilin ka rënë në heshtje. Në rrethana tjera, dispozita e nenit 100 të LPPA-së do të ishte pa efekt, pra asnjë qytetar, person fizik a juridik, nuk do ta kishte të mundshme të përfitonte nga mundësia ligjore e aprovimit në heshtje të kërkesës së tij/saj, si dhe procedura administrative dhe gjyqësore do ta prolongonte nxjerrjen e vendimit përfundimtar administrativ, gjë që do të ishte në kundërshtim me qëllimin vet nenit 100 të LPPA-së por edhe me parimin e efikasitetit të procedurës administrative.

Për këto arsye, si dhe duke u bazuar në nenin 4 dhe të 8 të LPPA-së, gjykata vlerëson se ligjërisht e ka për obligim që t'i ofroj palës mbrojtje gjyqësore duke i vërtetuar asaj se ka qenë e pajisur me aktin administrativ të miratuar në heshtje sipas kërkesës së saj që nga momenti kur autoriteti publik e ka lëshuar afatin për dhënien e aktit administrativ në bazë të kërkesës fillestare. Në lidhje me këtë, gjykata e sheh të arsyeshme të sqaroj se pika III. e dispozitivit të këtij aktgjykimit vetëm ka karakter deklarativ, pra vetëm konstaton ekzistimin e një akti administrativ, i cili tanimë veç në bazë të ligjit ekziston. Mbështetur në nenin 68 të LKA-së ku përcaktohet se *Vendimi në rastin e aprovimit të padisë deklarative “1. Për aq sa akti administrativ që ka pushuar së prodhuari pasoja juridike, veprimi tjetër administrativ që ka ndaluar, apo moskryerja e veprimit tjetër administrativ është i paligjshëm dhe ka cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të paditësit, gjykata deklaron paligjshmërinë e tij. 2. Për aq sa, akti administrativ apo raporti juridik, i të drejtës administrative ekziston apo nuk ekziston, gjykata deklaron ekzistencën apo përkatësisht mos-ekzistencën tij dhe saktëson të drejtat dhe detyrimet e paditësit.”*

Në anën tjetër, duke qenë se i Padituri pasi e ka miratuar aktin administrativ përmes heshtjes nuk ka pasur të drejtë të nxjerrë akt administrativ refuzues, atëherë gjykata erdhi në përfundim se vendimi i goditur është nxjerrë në kundërshtim me nenin 100 lidhur me nenin 52 para. 1 nën para. 2 të LPPA-së, andaj gjykata konform nenit 65 par. 1 nën të LKA-së, ku përcaktohet “1. Gjykata anulon tërësisht apo pjesërisht aktin administrativ, për aq sa akti është i paligjshëm dhe

cenon të drejtat apo interesat e ligjshëm të paditësit.” ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se natyra e konfliktit administrativ konkret është e atillë, që nuk është e nevojshme nxjerrja e aktit të ri administrativ, pasi që kërkesa e tij sipas fuqisë ligjore është miratuar, rrjedhimisht gjykata vendosi që vetë ta anuloj vendimin e atakuar, pa e obliguar të Paditurën që të nxjerr akt tjetër administrativ, pasi që vendimi i atakuar e i nxjerrë nga i padituri pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor për nxjerrjen e vendimit, është i përfshirë në shkelje të dispozitave të cekura më sipër.

Në këtë drejtim, gjykata ka marrë në konsideratë edhe udhëzimet dhe vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, të pasqyruara në aktvendimin K.DH.SH.II. nr.2186/24 të datës 30.09.2025, të cilat kanë shërbyer si orientim për vlerësimin e saktë të rrethanave faktike dhe juridike të çështjes.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në pajtim me nenin 101, nenin 2 paragrafi 3 të Ligjit për Kontestet Administrative, lidhur me nenin 463 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që secila palë t’i bartë vetë shpenzimet e veta të procedurës.

Prandaj duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 65 dhe 68 të LKA-së, lidhur me nenin 100 të LPPA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.697/25, datë 26.11.2025

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.